

POLITIKËBËRJA NË BALLKANIN PERËNDIMOR

*KRIJIMI I KËRKESES PËR EVIDENCA
PËRTEJ KUSHTËZIMIT NGA BE*



institut alternativa



Foreign Policy Initiative BH
FPT BH



GROUP FOR LEGAL AND POLITICAL STUDIES



Institute for Democracy and Mediation
Kuvendi për Demokraci dhe Ndërmjetësim



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Regional Research
Promotion Programme | Western Balkans



UNIVERSITÉ DE FRIBOURG
UNIVERSITÄT FREIBURG

POLITIKËBËRJA NË BALLKANIN PERËNDIMOR

KRIJIMI I KËRKESËS PËR EVIDENCA PËRTEJ KUSHTËZIMIT NGA BE

I. Pse duhet politikë-bërja?

Të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, që aspirojnë të anëtarësohen në Bashkimin Evropian (BE), e gjejnë veten në faza të ndryshme të procesit të integritimit në BE. Karakteristikat e qasjes së zgjerimit të BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor kërkon që këto vende të kenë rezultate konkrete, të prekshme dhe të qëndrueshme para se anëtarësohen. Në raundet e mëparshme të zgjerimit, BE nuk kishte përdorur asnjëherë mekanizma kaq të ndërlikuar për vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë së reformave të ndërmarra. Kjo situatë është e re si për Komisionin e BE-së ashtu edhe për vendet candidate¹, duke lënë të kuptohet se edhe BE po mëson nga përvoja dhe gabimet e saj dhe po ndërmerr risi në metodologjinë e saj për vlerësimin e rezultateve të arritura nga vendet candidate. Vetë vendet e Ballkanit Perëndimor po investojnë për krijimin e mjeteve dhe mekanizma të reja për të raportuar dhe monitoruar rezultatet e arritura. Më konkretisht, janë bërë përmirësime në lidhje me mbledhjen e të dhënave dhe metodat e analizave, cilësinë dhe besueshmërinë e të dhënave dhe angazhimin më konstruktiv me aktorët e shoqërisë civile.

1 Ky dokument përfshin në termin “vende candidate” për vendet e Ballkanit Perëndimor që janë zyrtarisht vende candidate për anëtarësim në BE (Serbia, Mali i Zi, Shqipëria, Maqedonia) dhe ato që janë ende candidate të mundshme (Bosnje dhe Hercegovina dhe Kosova).

Si udhëheqësit politikë të BE-së ashtu edhe ata të Ballkanit Perëndimor kanë theksuar në mënyrë të përsëritur se këto reforma bëhen jo si përgjigje ndaj kërkesave të BE-së, por në radhë të parë për përmirësimin e këtyre vendeve dhe të vetë rajonit².


Në fakt, do të ishte gabim të paraqitej synimi i anëtarësimit në BE si e vetmja arsye për ndërmarrjen e reformave në sistem. Për këtë arsye, qëndrueshmëria e reformave nevojitet si në fazën e pas anëtarësimit ashtu edhe në rastin e ngadalësimit apo pezullimit të procesit të anëtarësimit, duke pasur parasysh se rrethanat aktuale janë të pafavorshme dhe dëmtojnë politikën e zgjerimit të BE-së.

Vendet nga Ballkani Perëndimor që aspirojnë të anëtarësohen në BE e gjejnë veten në një proces të gjatë dhe të vështirë të përmirësimit të sistemeve të tyre të bërjes së politikave. Për rezultate të qëndrueshme kërkohen jo vetëm mjete e procedura të qëndrueshme por edhe përfshirja në hartimin e politikave të të gjitha palëve të interesuara, si shoqëria civile, media, grupet e interesit dhe shoqatat. Megjithatë, politikëbërja si temë është hulumtuar fare pak dhe rëndësia e saj nuk është vlerësuar si[duhet si nga shteti ashtu edhe nga aktorët e shoqërisë civile në rajon. Në këtë dokument paraqiten argumente për të nxjerrë në pah nevojën për angazhim më të efektshëm të shoqërisë civile për të vepruar si kontrollues efikas i reformave në politikëbërje si dhe për të marrë një rol më konstruktiv në proceset politikëbërëse, duke e bërë këtë proces më transparent dhe të bazuar në evidenca.

2 Shih për shembull, Komunikim për Politikën e BE-së për Zgjerim 2016, f. 2, gjendet tek: <https://goo.gl/0pa1iC>

Formulimi i politikave

- Përcaktimi i përparësive (përcaktimi i agjendës)
- Njohja dhe analizimi i problemit
- Hartimi i politikave - përgatitja e propozimit për politikën dhe formulimi i alternativave të politikës
- Vlerësimi i ndikimit ex-ante (para faktit) përfshirë analizimin e opsioneve për politikën
- Zgjedhja e opsionit të politikës
- Konsultimet ndërministrorë
- Konsultime të vazhdueshme



Realizimi i politikave

- Marrja e vendimit për politikën e propozuar
- Përgatitja e draftit ligjor apo instrumenteve të tjera të politikës, përfshirë vlerësimin e vazhdueshëm të ndikimit të legjislacionit
- Bashkërendimi në nivel qeverie
- Konsultime të tjera

Të mësuarit e politikave

- Zbatimi i politikës
- Monitorimi i politikës
- Vlerësimi i politikës dhe rinisja e ciklit të politikës

Grafiku 1: Skema e ciklit të politikave⁴

Procesi i politikëbërjes i deshifruar

Sipas OECD/SIGMA, për politikëbërje efektive duhet të mundësohen komponentët e mëposhtëm:

- Sistem i mirë organizuar, i qëndrueshëm dhe kompetent në qendër të institucioneve qeveritare;
- Harmonizim në planifikimin e politikave që përputhen me kushtet financiare të vendit dhe që ndihmojnë qeverinë në arritjen e objektivave të saj;
- Vendime transparente, në përputhje me ligjet, të kuptueshme dhe të aksesueshëm nga publiku të marra nga qeveria;
- Kontroll parlamentar që funksionon mirë;
- Hartim gjithëpërfshirës, bazuar në evidenca i politikave dhe ligjeve³.

Vendet me politikëbërje efektive i investojnë në mënyrë racionale burimet e tyre financiare dhe njerëzore kur hartojnë një politikë të re. Ato i kushtojnë shumë vëmendje detyrave analitike përpara se të bëjnë zgjedhjen e tyre në lidhje me opsionin më të mirë të politikave. Po ashtu, ato mundësojnë hapësirë të mjaftueshme publike për ndërhyrje nga aktorë të interesuar në hartimin dhe monitorimin e politikave.

Për të shpjeguar dhe për të nxjerrë në pah rëndësinë e politikave të shëndosha në cilësinë e shërbimeve publike, në ecurinë ekonomike dhe zbatimin e politikave të një vendi, politikëbërja si një proces i pafund mund të ndahet në tri faza funksionale:

Të tre fazat e politikëbërjes janë të ndërvarura dhe të ndërlidhura. Faza e parë, formulimi i politikave, priret të nënvlerësohet në vendet me kulturë të fortë administrative “legalistike”. Në fakt, kjo fazë është shumë e rëndësishme, pasi në të përcaktohen mënyra se si do të vijohet me politikën si dhe perspektivat për zbatimin e një politike të caktuar. Nëse faza e formulimit të politikave nuk realizohet siç duhet, ekziston rreziku i zbatimit të dobët të politikës gjë që sjell si nevojë rinisjen nga pika fillestare, ndoshta duke rezultuar në humbje të mëdha financiare, kohë dhe burimesh të tjera të vlefshme. Nëse themelet e politikave hidhen përmes formulimit të duhur të politikave, faza e dytë, zbatimi i politikave, ka më shumë gjasa të realizohet me sukses.⁵ Ashtu si me fazën e mësimin të politikave, është e rëndësishme të paracaktohen në fazën e formulimit të politikave qëllimet e dëshiruara dhe treguesit që do të përdoren për matjen e shkallës së suksesit. Roli i fazës së mësimin të politikave është të tregojë mësimet e nxjerra dhe të evidentojë problemet që kanë ndodhur gjatë zbatimit të dy fazave të mëparshme. Faza e mësimin të politikave duhet të japë përgjigje për efektet e politikës po zbatohet: nëse rruga përpara është të ndryshojë politikën, ta rishikojë atë, apo për përpiqet për një zgjidhje të ndryshme. Monitorimi dhe vlerësimi i politikave përbëjnë një burim të vazhdueshëm informacioni që i ndihmon politikëbërësit të arritur rezultatet e dëshiruara.⁶

3 OECD/SIGMA (Mbështetje për përmirësimin e qeverisjes dhe menaxhimit - Support for Improvement in Governance and Management), Hartimi dhe Bashkërendimi i Politikave, gjendet tek: <https://goo.gl/g2AD4U>

4 M. Lazarevic et al., Policymaking and EU Accession Negotiations: Getting Results for Serbia”, Qendra e Politikave Evropiane (CEP), Beograd, dhjetor 2013

5 S. Maric et al., Getting Results in Public Policies: Monitoring & Evaluation with the Evidence Supplied by the Civil Society, Qendra Evropiane e Politikave (CEP), Fondacioni për Avancimin e Shkencave Ekonomike, Beograd, 2014. <https://goo.gl/NLOf5W>

6 J. Z. Ruzek, R. C. Rist, “Ten Steps to a Results-Based Monitoring and Evaluation System,” Banka Botërore, 2004, f. xii.

Sistemet efektive të politikëbërjes, të tilla si ai në Mbretërinë e Bashkuar, karakterizohen nga praktika që janë zhvilluara me kujdes dhe që kanë të bëjnë me fazën e formulimit të politikave. Në sistemin britanik, si aktorët e brendshëm ashtu edhe ata të jashtëm mund të bëhen nismëtarë të një politike të re, në bazë të të cilit ministria kompetente përgatit atë që quhet dokument politikash. Ky dokument kompleks analitik përfundon me ofrimin e alternativave të ndryshme të politikave, që më pas diskutohen brenda administratës por edhe me partnerë të jashtëm dhe aktorë të tjerë. Disa nga alternativat mund të kërkojnë studime e analiza të mëtejshme, sepse sa më e ndërlikuar të jenë politikat në fjalë, që më i gjithanshëm do të jetë procesi i politikëbërjes. I gjithë procesi dhe cilësia e qasjes analitike shqyrtohen nga një institucion qendror i qeverisë si dhe nëpërmjet vlerësimeve të shumta të ndikimit të politikave në studim. Para se të bëhet zgjedhja përfundimtare për politikën që duhet të ndiqet, krijohet një komision i pavarur rregullator që do të vlerësojë cilësinë e analizave të kryera për ndikimin e politikës dhe që do të japë rekomandime nëse një politikë e dhënë kërkon legjislacion të veçantë apo mund të rregullohet me kuadrin ekzistues ligjor.⁷ Procesi të tilla të mirë studiuar të politikëbërjes parandalojnë teprimin me ligje, ndihmojnë të kursehen paratë e taksapaguesve dhe sigurojnë një ekuilibër më të mirë mes kostos dhe përfitimit.

Në kontekstin e BE-së, cilësia e sistemeve të politikëbërjes së shteteve anëtare është vërtetuar se ka rëndësi të madhe për negocimin e suksesshëm të politikave të BE-së në Këshillin e forumeve të BE-së. Anëtarësia në BE shoqërohet nga kërkesa gjithnjë e më të mëdha për administratat e shteteve anëtare.⁸ Studimet kanë treguar se vendet që kanë sistemet kombëtare të zhvilluara mirë dhe efektive të politikëbërjes ia dalin mirë edhe kur mbrojnë pozicionet e tyre kombëtare në proceset e hartimit të politikave në nivel BE-je. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për shtetet e vogla, të tilla si Letonia, suksesi i së cilës në arenën e Këshillit mund t'i atribuohet një procesi mbarëkombëtar të politikëbërjes të bazuar në evidenca.⁹ Pozicioni kombëtar që mbrohet me argumente të bazuar në prova dhe në përgatitjet paraprake ka mundësi më të mëdha për të dalë me suksese në krahasim me atë që paraprihet nga një proces i pasistemuar dhe me informacioni të pamjaftueshëm për hartimin e politikave.¹⁰

Në të njëjtat linja, procesi i anëtarësimit në BE ka shumë paralele me diskutimet politike mes

shteteve anëtare në arenën Këshillit. Negociatat e anëtarësimit janë një instrument mjaft i mirë për vendet candidate, të cilat mund të mësojnë si të përgatiten për ballafaqimin me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në BE, duke pasur parasysh se rezultati i negociatave për anëtarësim, për shembull, mënyra se negociohen përjashtimet kalimtare, mund të varen kryesisht nga cilësia e sistemeve të tyre të politikëbërjes.¹¹ Në realitet, leverdia e procesit të integritimit në BE, pavarësisht motiveve të jashtme të mundshme negative dhe rezultatit të pasigurt të anëtarësimit, është se ai motivon, madje edhe i detyron, vendet candidate të ndryshojnë dhe përmirësojnë sistemet e tyre të politikëbërjes në planin afatgjatë. Kjo lloj reforme ndihmon në arritjen e rezultate të përmirësimit të politikave në të gjitha fushat, pavarësisht fatit të vendit kur bie fjala për çështjen e përmbushjes së synimit për anëtarësim në BE.

II. Vlerësimi i sistemeve të politikëbërjes në rajon

Të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor duket se kanë një rrugë të gjatë përpara për sa i përket krijimit të sistemeve efektive të politikëbërjes. Dobësitë e evidentuara vijnë nga një kuadër i gjerë shoqëror që lidhet jo vetëm me kulturë burokratike legalistike të përmendur më sipër por edhe me trashëgimitë komuniste dhe tranzitore, që pasqyrohen në procesin e decentralizuar të vendimmarrjes, politikëbërjes jo-transparente, kapjes së institucioneve, dhe përhapjes së klientelizmit. Këto fenomene nuk mund të kapërcehen në kohë të shkurtër duke qenë se ato kërkojnë ndryshime të rëndësishme social-kulturore.

Komisioni Evropian pranon se shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor kanë bërë përparim në miratimin e ligjeve moderne për procedurat e përgjithshme administrative, por siguria ligjore mund të arrihet vetëm kur procedurat administrative që vijnë në kundërshtim me ligjet sektoriale trajtohen me efektivitet dhe eliminohen.¹² Për më tepër, vendet duhet të gjejnë mënyra të përshtatshme për të harmonizuar qeveritë qendrore, rajonale dhe vendore për të siguruar mbështetje për zbatimin e

7 M. Lazarevic et al., cituar më sipër, fq. 55-59.

8 Les Metcalfe, International Policy Co-ordination and Public Management Reform, Revista Ndërkombëtare e Shkencave Administrative, Vol. 60, 1994, fq. 271-90.

9 M. Lazarevic et al., cituar më sipër, fq. 112-115.

10 Po aty, fq. 94.

11 Po aty, fq. 96.

12 Vështrim krahasues i Raporteve të Vendit për 2016, Kreu II - Kriteret Politike, pjesa e reformës së administratës publike: <https://goo.gl/sG09Yo>

reformave. Të gjitha vendet duhet të respektojnë dhe të sigurojnë të drejtat e qytetarëve për sa i përket aksesit në informacion, shërbimeve administrative, dhe administrimit të mirë (prezantimi i e-qeverisë është prioritet në këtë drejtim).¹³ Të gjitha këto probleme të politikës ndikohen nga praktika të papërshtatshme të politikëbërjes. Në këtë kontekst, nga analiza krahasuese e Raporteve të Vendit të Komisionit Evropian të vitit 2015 me vitin 2016 del në pah një ritëm disi i ngadaltë i progresit të arritur nga vendet kandidatë për përmirësimin e sistemeve të tyre të politikëbërjes.

Mungesa e politikëbërjes transparente dhe të bazuar në evidencë: kush e ka fajin?

Raportet e Vendit për vitin 2015 theksojnë se elementët formalë të politikëbërjes, d.m.th., baza ligjore dhe institucionet për një sistem më koherent të politikëbërjes, përfshirë këtu edhe integrimin evropian, janë krijuar tashmë në të gjitha vendet e rajonit. Megjithatë, problemet kryesore të identifikuar lidhen me koordinimin e politikave dhe zbatimin aktual të tyre. Koordinimi i politikave është i dobët dhe ka shpesh ka mbivendosje të strategjive dhe funksioneve mes ministrive të ndryshme, Sekretariatit të Përgjithshëm, dhe institucioneve të tjera qeveritare. Koordinimi i politikave fokusohet shumë në çështjet procedurale dhe nuk merret shumë me thelbin e vetë politikave. Strategjitë sektoriale hartohen pa u konsultuar me njëra tjetrën dhe shpesh u mungojnë burimet financiare ose lidhja me kuadrin afatmesëm të shpenzimeve, pra duke vënë në rrezik zbatimin e tyre në të ardhmen në të gjithë rajonin.

Kuadri formal për hartimin e politikave dhe ligjeve gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në evidencë është krijuar pjesërisht ose plotësisht në pjesën më të madhe të vendeve. Kapacitetet për hartimin e politikave janë e pamjaftueshme, përgjithësisht për shkak të mungesës së burimeve njerëzore apo për shkak të fokusit të nevojshëm në zbatimin e politikave. Në të gjashtë vendet, janë të nevojshme konsultimet publike dhe ndërministrorë për propozimet e politikave, por ato shpesh bëhen në mënyrë formale dhe me mjaft vonesa në këtë proces. Në përgjithësi bëhen vlerësime për ndikimin e ligjeve dhe politikave, por cilësia e tyre ndryshon shumë. Vlerësimet e ndikimit nuk kryhen sistematikisht dhe cilësia e tyre ndryshon nga institucioni në tjetrin në pjesën më të madhe rasteve. Është ngritur sistemi për monitorimin e performancës së qeverisë, edhe

pse ai nuk është i efektshëm për të siguruar kontroll efikas të publikut mbi punën e qeverisë, ndërkohë që raportet e monitorimit të qeverisë përqendrohen kryesisht më shumë tek produktet sesa në arritjet sipas objektivave të politikës.¹⁴

Raportet e vitit 2016 paraqesin një pamje edhe më kritike të situatës aktuale për këtë çështje. Ato nxjerrin në pah dukurinë mjaft të përhapur që ka të bëjë me afatet tepër të shkurtra kohore për konsultimin publik në fazën e formulimit të politikave në të gjitha vendet. Konsultimet publike bëhen formalisht, pa angazhim dhe përfshirje serioze të palëve të tjera, gjë që sjell si rezultat zbatim të dobët ligjeve në fuqi. Në të njëjtën kohë, kontrolli publik i punës së qeverisë në fazën e monitorimit të politikave paraqet mjaft probleme, duke qenë se dokumentet e qeverisë shpesh nuk bëhen publike.

Këtë vit ka rëndësi të theksohet se Komisioni me të vërtetë pranoi problemin e vazhdueshëm të shtyrjes së afateve të lidhura me përafrimin me acquis të imponuara nga procesi i asocimit/anëtarësimit në BE në të mirë të cilësisë së legjisllacionit të miratuar. Për qeveritë e rajonit, kërkesat e mëdha të procesit të integritimit në BE shpesh përbëjnë një justifikim për miratimin e legjisllacionit në afate të shkurtra kohore duke anashkaluar kështu përfshirjen e publikut. Duket se për vite me radhë Komisioni bëri një sy qorr për këtë çështje. Një nga shembujt më të dukshëm është rasti i Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në Serbi i miratuar në vitin 2011, ligj që ishte plotësisht i harmonizuar me acquis të BE-së në këtë fushë, por nuk ishte praktikisht i zbatueshëm në praktikë duke qenë se në hartimin e tij i saj u eliminua pothuajse plotësisht faza e formulimit të politikave - në të nuk u përfshinë as detyrat analitike dhe as aktorët e interesuar në procesin e hartimit të politikave.¹⁵ Për më tepër, miratimi i tij u bë me ngut në mënyrë që ligji “të arrinte në kohë”, pra që të përfshihej në Raportin e Progresit të atij viti.

Një përfundim i ngjashëm mund të nxirret edhe nga shembulli i reformave të sektorit të drejtësisë në Bosnje-Hercegovinë, që rezultoi në cilësi të dobët dhe zbatueshmërisë të ulët, për shkak të afateve shumë të shkurtra kohore të përcaktuara për miratimin e tyre dhe mungesa e një analizimi të mirëfilltë.¹⁶ Miratimi i paketës ligjore për reformën në drejtësi ishte edhe një kërkesë e

14 Vështrim krahasues i Raporteve të 6 Vendeve për 2015 për hartim politikash dhe koordinim. Raportet gjenden në adresën: <https://goo.gl/UU7Fk4> Analizë krahasuese e raporteve SIGMA të vendit për hartimin dhe bashkërendimin e politikave, Parimet 5, 6, 10 dhe 11. Gjendet tek: <https://goo.gl/omymeg>

15 N. Lazarevic et al., “Towards a European Level of Consumer Protection in Serbia”, Beograd 2012, në adresën: <https://goo.gl/Qbmk14>


16 Asocijacija za demokratske inicijative, Centri civilnih inicijativa, Značaj analitičkog principa u formulisanju javnih politika i propisa u sektoru pravde u Bosni i Hercegovini, Sarajevo, 2012, fq. 8-9, gjendet tek: <https://goo.gl/V9IKJx>

13 2016 Komunikim për Politikën e BE-së për Zgjerimin, gjendet tek: <https://goo.gl/60CnjN>

vendosur nga Komisioni Evropian për Kosovë.¹⁷ Në këtë kërkesë Parlamentit të Kosovës i kërkohej të ndryshonte dhe miratonte një sërë ligjesh të rëndësishme me një ritëm të shpejtë, si pasojë e të cilit u anashkalua konteksti social-ekonomik i vendit. Përveç kësaj, afati i shkurtër kohor bërë të pamundur që të gjithë aktorët të merrnin pjesë në procesin e hartimit të legjislacionit, ose, edhe kur morën pjesë, kontributi i tyre ishte i pamjaftueshëm, pasi nuk mund të kryenin

efikase.”¹⁹ Në dy vitet e fundit, kriza e vështirë politike shkaktoi një përkeqësim të procesit të hartimit të politikave në përgjithësi. Kështu, në vitin 2016 Komisioni vëren se, edhe pse kuadri ligjor është miratuar tashmë, “konsultimet publike dhe ato mes ministrive për politikën dhe legjislacionin mbetën thjesht një formalitet [dhe] cilësia e vlerësimeve të detyrueshme për ndikimin e kuadrit rregullator të propozimeve legjislative dhe i politikave është e dobët.”²⁰

Vlerësimi me treguesit SIGMA për cilësinë e hartimit të politikave



Grafiku 2: Vështrim krahasues i vlerësimeve të SIGMA-s për cilësinë e hartimit të politikave²¹

analizat e duhura për të vlerësuar ndikimin e ndryshimeve të propozuara. Kështu, sfidat e zbatimit të këtij legjislacioni u rritën dhe paketa ligjore duhej të rishikohej për t’u ndryshuar më pas në vitin 2015.¹⁸ Duhet të theksohet se disa ligje të paketës së drejtësisë mund të ndryshohen përsëri këtë vit, duke pasur parasysh se ato janë të integruara në Planin Legjislativ për vitin 2016.

Nga ana tjetër, në rastin e Maqedonisë, për shkak të status quo-së në pranimin në BE, situata është krejt e ndryshme. Në sajë të përpjekjeve dhjetëvjeçare, sipas Raportit të Progresit të KE-së për vitin 2014 për Maqedoninë, “procedurat për hartimin e politikave dhe koordinimin e të gjithë sektorëve janë të përcaktuara mirë, [edhe pse ato] nuk zbatohen gjithmonë në mënyrë

17 Raport nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin për progresin nga Kosova* në përmbushjen e kërkesave të udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave. (2013). Komisioni Evropian. Gjendet tek: <https://goo.gl/YUrsFn>

18 Kosova Sot (2015). Miratohet pakoja ligjore për drejtësinë si kriter për liberalizimin e vizave. Gjendet në: <https://goo.gl/ee39QC>

19 Komisioni Evropian, Dokument Pune. Progres Raporti për Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, 2014, 8. Gjendet tek: <https://goo.gl/2iuiuU>

20 Komisioni Evropian, Dokument Pune. Progres Raporti për Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, 2016, Gjendet tek: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2016/20161109_report_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia.pdf fq. 10

21 Për treguesin “Shkalla në të cilën në procesin e zhvillimit të politikave përdoren më mirë mjetet analitike”, në një shkallë 0-5, ku 0 do të thotë “nuk përdoren teknika analitike të sistemit”; 1- “përdoren teknika të thjeshtëzuara dhe vetëm me rastë”; 2- “përdoren teknika të thjeshtëzuara por në mënyrë të rregullt”; 3- “Ekziston analiza para faktit, por nuk është gjithëpërfshirëse”; 4- “analiza para faktit kryhet rregullisht me cilësi të mjaftueshme për të paktën disa elemente”; dhe 5- “analiza gjithëpërfshirëse para faktit kryhet rregullisht”. Për treguesin “Shkalla në të cilën në hartimin e politikave dhe të legjislacionit përdoret konsultimi publik”, 0- “nuk bëhet fare konsultim”; 1- “konsultimi bëhet në mënyrë sporadike dhe në baza rastësore, pa rregullore ku përcaktohen procedura të qarta”; 2- “rregullorja është në fuqi, por zbatohet me hope dhe në mënyra të ndryshme”; 3- “është miratuar rregullorja me procedura të qarta, zbatohet rregullisht, por nuk ka mekanizma monitorimi”; 4- “është miratuar rregullorja me procedura të qarta, zbatohet rregullisht dhe ka edhe mekanizma monitorimi”; 5- “është miratuar rregullorja me procedura të qarta, zbatohet rregullisht, ka edhe mekanizma monitorimi, plus që rezultatet e konsultimeve bëhen publike”.

Duke vendosur presion më të madh në këtë aspekt të rëndësishëm të procesit të hartimit të politikave, Komisioni duket se ka mësuar nga gabimet e tij. Pra, ai ka ndryshuar qëndrim dhe tani i kushton më shumë vëmendje kushteve që mundësojnë përfshirje më të madhe të shoqërisë civile dhe palëve të treta në rajon në procesin e politikëbërjes. Shembujt e vendeve të mësipërme tregojnë se rrethanat në terren janë vazhdimisht në ndryshim të shpejtë dhe ilustrojnë nevojën për presion nga poshtë lart prej OSHC-ve vendore dhe komunitetit të organizatave studimore.

Kapacitetet e dobëta analitike dhe monitoruese përkundër rritjes së kërkesave

Vlerësimet e Komisionit dhe SIGMA theksojnë nga ana tjetër se edhe vetë qeveritë nuk kanë aftësitë dhe kapacitete të mjaftueshme për monitorimin e zbatimit të politikave, duke qenë se në shumicën e rasteve nuk mund të matet arritja e objektivave të synuara.²² Një situatë e tillë e lojës është në kundërshtim me kërkesat e procesit të anëtarësimit në BE. Në vitin 2015, Komisioni përditësoi metodologjinë e vlerësimit duke këmbëngulur, ndër të tjera, në evidentimin e rezultateve konkrete në vendet candidate.²³ Në fakt, Komisioni po i kushton më shumë vëmendje monitorimit të qëndrueshmërisë së rezultateve të arritura, duke kërkuar nga vendet candidate të përmirësojnë kapacitetet e tyre analitike dhe të mbledhjes së të dhënave, përfshirë këtu edhe ofrimin e “informacioneve statistikore të besueshme dhe të krahasueshme për zbatimin e reformave.”²⁴

Në Serbi, për shembull, procesi i anëtarësimit ka nxitur qeverinë të punuar shumë për përmirësimin e mbledhjes së të dhënave të saj dhe monitorimin e kapaciteteve, veçanërisht në fushat të cilat Komisioni i konsideron si

“thelbësore”.²⁵ Hartimi i planeve të detajuara të veprimit, ku të përcaktohen objektiva dhe afate të qarta kohore, objektiva në nivele të ndryshme, treguesit SMART, burimet e verifikimit, dhe burimet e financimit, ishte një nga parakushtet për hapjen e kapitujve 23 dhe 24 të negociatave. Zbatimi i planeve të veprimit do të monitorohen dy herë në vit nga Komisioni, ndërkohë që Serbisë do t’i duhet të dorëzojë raporte 6-mujore.²⁶ Të njëjtat mekanizma do të duhet të zbatohet për të paktën nëntë kapituj të tjerë të negociatave, d.m.th., ato për të cilat janë përcaktuar treguesit e hapjes.²⁷

Në këtë drejtim, Maqedonia, edhe sikur të ketë përfshirë zyrtarisht monitorimin e politikave në procedurat e punës së Qeverisë, veçanërisht në aspektin e monitorimit nga lart poshtë (d.m.th., planin e punës të Qeverisë), në praktikë kjo gjë nuk zbatohet në mënyrë sistematike në të gjitha nivelet e qeverisjes.²⁸

Sa efektiv është presioni nga OSHC-të për përmirësimin e politikëbërjes?

Duke pasur parasysh kompleksitetin e sfidave me të cilat hasen administratat e Ballkanit Perëndimor, nuk është e habitshme që këto administrata duket se i kanë bërë rezistencë ndryshimeve të mëdha në kulturën dhe praktikën e tyre administrative. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet se ndryshimet pozitive dhe përmirësimet e qëndrueshme marrin kohë. Gjithsesi, ajo që është e jashtëzakonshme është fakti se Komisioni Evropian dhe kërkesat e procesit të integritetit në BE deri tani kanë përfaqësuar burimin më efektiv dhe më të hapur të presionit për reforma në politikëbërje. Shoqëria civile në

22 Vështrim krahasues i Raportëve të 6 Vendeve për vitin 2016 për hartim politikash dhe koordinim. Raportet gjenden tek: <https://goo.gl/1L2kQf>

23 Strategjia e Zgjerimit të BE-së 2015, Shtojca II, fq. 31, gjendet tek: <https://goo.gl/aOGRcn>

24 Kuadri i negociatave BE - Serbi, fq. 20, gjendet tek: <https://goo.gl/7eH8Mp>

25 Sipas metodologjisë së përditësuar të prezantuar në 2015, janë këto: shteti ligjor dhe të drejtat themelore (funksionimi i gjyqësorit, korrupsioni, krimi i organizuar, liria e shprehjes); Kriteret ekonomike; reforma e administratës publike; Tre kapitujt e lidhur ngushtë me sa më sipër (prokurimi publik, statistikat, kontrolli financiar)

26 Komisioni Evropian, 2016 Komunikimi për Politikën e BE-së për Zgjerim, fq. 9, gjendet tek: <https://goo.gl/K2ar5m>

27 Raportet e monitorimit për nëntë kapitujt e negociatave të përcaktojnë treguesit e hapjes, pjesë më e madhe e të cilave në formën e hartimit të një plani të detajuar veprimi. Komisioni nuk i ka botuar ende raportet e monitorimit për shtatë kapitujt e negociatave. Raportet gjenden tek: <https://goo.gl/yb44vs>

28 Vlerësimi i SIGMA-s për Reformën në Administratën Publike të Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, 2014, 11. Gjendet tek: <https://goo.gl/TfHNva>

rajon ka ngritur zërin duke insistuar për përfshirje më të madhe të saj në procesin e hartimit të politikave, edhe pse rezultatet kanë qenë të pamjaftueshme.

Lidhur me aktorët e shoqërisë civile, dy janë faktorët kryesorë që kanë kontribuar në përfshirjen e tyre të pamjaftueshme. Së pari, një pjesë e fajit i takon kuadrin të pafavorshëm ligjor dhe institucional për përfshirjen e shoqërisë civile në politikëbërje. Duke qenë se sistemet e politikëbërjes në rajonit përqendrohen kryesisht në fazën e hartimit të ligjeve, por pa zhvilluar fazën e formulimit të politikave dhe atë të monitorimit, OSHC-të kanë shumë pak mekanizma për të ndikuar në drejtimin e politikave që po hartohen apo për të monitoruar zbatimin e tyre. Në një kontekst më të gjerë, në Raportin Rajonal të 2015 për Matricën e Monitorimit për Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile vihet në dukje se “sfidat me funksionalitetin e partneriteteve OSHC-qeveri lidhen në mënyrë të veçantë me zbatimin e pamjaftueshëm të masave të përcaktuara nga dokumentet e politikave.”²⁹

Në Serbi, pjesëmarrja e OSHC-ve është ad-hoc, shpesh në formë reagimi dhe jo në kohën e duhur, ndërkohë që përfshirja e tyre në politikëbërje kufizohet kryesisht në pjesëmarrjen në diskutime publike dhe në grupet e punës për hartimin e ligjeve. Në vitin 2014, Qeveria miratoi Udhëzimet për Përfshirjen e OSHC-ve në Miratimin e Ligjeve, por këto udhëzime i referohen vetëm procesit të hartimit të ligjit dhe jo të gjithë ciklit të politikave, duke dëmtuar kështu trajtimin në nivel sistemi të përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile.³⁰ Në Bosnje-Hercegovinë nuk është krijuar ende kuadri strategjik për bashkëpunim mes OSHC-ve dhe qeverisë. Ky kuadër do të bënte të mundur një bashkëpunim më koherent e të qëndrueshëm dhe do të përbënte një mundësi që OSHC-të të marrin pjesë në mënyrë aktive në sistemin e politikëbërjes. Komuniteti i OSHC-ve ka punuar për edukimin e qytetarëve dhe aktorëve të tjerë për mënyrën se si të ndikojnë në sistemin e politikëbërjes në Bosnje-Hercegovinë me qëllim që procesi të bëhet më i kuptueshëm e më i qartë dhe, rrjedhimisht, edhe me i aksesueshëm për qytetarët e zakonshëm.^{31,32} Rasti i politikave të mbrojtjes sociale në Shqipëri tregon mungesën e besimit mes shtetit dhe sektorit civil, kur bie fjala për sigurimin e evidencave

të rëndësishme për hartimin e politikave, pasi të dy palët janë skeptikë në lidhje me cilësinë e të dhënave që ka mbledhur pala tjetër.³³

Faktori i dytë ka të bëjë me kapacitetet e kufizuara të OSHC-ve për të mbrojtur një politikëbërje më transparente dhe të bazuar në evidenca. Mund të debatohet se kjo mund t’i atribuohet pjesërisht qasjes së papërshtatshme ndaj sektorit civil nga komuniteti i donatorëve. Mbështetja e donatorëve bazohet kryesisht në projekte duke bërë që organizatat e shoqërisë civile t’i kushtojnë më shumë kohë dhe burime njerëzore procedurave të aplikimit për projekte, gjë që sjell si rezultat rritjen e distancës mes OSHC-ve dhe komuniteteve të tyre.³⁴ Siç është evidentuar edhe nga TACSO, një dobësi e dukshme në të gjithë rajonin është numri ende i ulët i OSHC-ve që trajtojnë promovimin e qeverisjes së mirë, veçanërisht i atyre organizatave që fokusojnë punën e tyre në mbikëqyrjen e administratës publike. Përveç kësaj, pavarësisht disa organizatave ‘think tank’ pioniere, kapacitetet analitike të shoqërisë civile në përgjithësi janë të zhvilluara fare pak.³⁵ Në Serbi, studimet tregojnë se pjesa më e madhe e OSHC-ve kanë potenciale të kufizuara për të marrë pjesë në procesin e monitorimit të politikave dhe e konsiderojnë veten si pamjaftueshmërisht të vetëdijshëm për mundësitë ekzistuese në këtë drejtim.³⁶

Komisioni Evropian ka evoluar në drejtim të qasjes së tij ndaj OSHC-ve në Ballkanin Perëndimor, nga fokus fillestar për krijimin e kapaciteteve të brendshme tek vënia e theksit në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për OSHC-të, për të trajtuar më në fund marrëdhëniet shtet-shoqëri civile.³⁷ Qasja e re e BE-së në politikën e zgjerimit rrit në mënyrë të barabartë pritshmëritë nga shoqëria civile, sidomos për sa i përket kontributit të tyre në rritjen e llogaridhënies politike dhe nxitjen e mundësive që të “kuptohen më mirë reformat që kanë të bëjnë me anëtarësimin”.³⁸

Duke marrë shembullin e Serbisë, mund të vihet re lidhja mes përsheptimit të procesit të anëtarësimit që nga viti 2014 dhe rritjes së përfshirjes së OSHC-ve në politikëbërje. Zyra e Qeverisë për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile ka luajtur një rol të rëndësishëm

29 Raporti Rajonal i 2015 për Matricën e Monitorimit për Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë civile, <https://goo.gl/Xp6bPu>

30 A. Orza, Civil Society and Government: Participatory Policy Formulation in Serbia, Qendra Evropiane e Politikave, Beograd, 2014, gjendet tek: <https://goo.gl/FbpgEB>

31 Të Drejtat Globale, Vodič za zakonodavno zagovaranje, 2005, gjendet tek: <https://goo.gl/vnepTE>

32 Javna rasprava, gjendet tek: <https://goo.gl/kDOE57>

33 Marsela Dauti, Erika Bejko, Përdorimi i Evidencës Shkencore në Hartimin e Politikave të Mbrojtjes Sociale në Shqipëri, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, janar 2015, fq. 2.

34 N. Wunch, Right Goals, Wrong Tools? Civil Society Empowerment in the EU Accession Process, DGAPanalyse, Shkurt 2015, fq. 4, gjendet tek: <https://goo.gl/Bk9Peh>

35 Kapacitetet e Shoqërisë Civile në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi: Përmbledhje Krahasuese e Tetë Vendeve - Vlerësim i nevojave të OSHC-ve. Raport i përgatitur nga TACSO (Asistencë Teknike për Organizatat e Shoqërisë Civile në Vendet IPA) tetor 2010, Gjendet tek: <https://goo.gl/CQHcKq>

36 S. Maric et al., cituar më sipër, fq. 47-49.

37 N. Wunch, cituar më sipër, fq. 5.

38 Strategjia e Zgjerimit të BE-së 2015, cituar më sipër, fq. 4.

në këtë drejtim, duke organizuar trajnime dhe seminare të shumta për ngritjen e kapaciteteve me qëllim ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit nga ana e OSHC-ve të veçorive të procesit të anëtarësimit dhe për përmbajtjen e secilit kapitull të negociatave. Një tjetër moment i rëndësishëm ishte krijimi i Konventës Kombëtare për Bashkimin Evropian, një forum gjithëpërfshirës me pjesëmarrjen e sektorit civil në procesin e anëtarësimit në BE dhe monitorimin e tij. Nuk është për t'u habitur se pjesëmarrja e OSHC-ve deri tani ka qenë më dinamika në grupet e punës në lidhje me kapitujt 23 dhe 24, duke pasur parasysh kompleksitetin e veprimeve që nevojiten të realizohen për të bërë përparime të rëndësishme në këto kapituj dhe faktin se pjesa më e madhe e OSHC-ve aktive në Serbi janë të fokusuar në çështjet e të drejtave të njeriut.³⁹

Megjithatë, është ende herët të vlerësohet nëse praktikat pozitive të evidentuara deri tani nëpërmjet Konventës Kombëtare dhe forume të tjera do të rezultojë në bashkëpunim thelbësor dhe efikas mes shtetit dhe sektorit civil. Më konkretisht, kontributet e OSHC-ve deri më tani kufizohen kryesisht në ofrimin e sugjerimeve në lidhje me sqarimet e planeve të veprimit dhe dokumente të tjera që ka të bëjnë me anëtarësimin, dhe jo me ofrimin në përgjithësi të një kontributi më cilësor në procesin e anëtarësimit. Një tjetër provë për gatishmërinë e sektorit shtetëror për të përfshirë sektorin civil do të bëhet në fazën e monitorimit, kur të lindë nevoja për të vërtetuar reformat e ndërmarra përmes raportimit transparent dhe të bazuar në evidencë. Në të njëjtën kohë, periudha e ardhshme do të tregojnë nëse shoqëria civile ka ndërtuar kapacitetet e duhura për të luajtur një rol konstruktiv në reformat e politikëbërjes, pavarësisht dinamikës dhe kërkesave e procesit të anëtarësimit në BE.

Nga ana tjetër, në vendet që nuk janë në procesin e negociatave për anëtarësim, rruga e zhvillimit të dialogut të qeverisë me OSHC-të është shumë e ndryshme, edhe pse procesi i anëtarësimit në BE shihet si mundësi për rritjen e rolit të këtyre organizatave në hartimin e politikave. Në këtë drejtim, Raporti 2016 i Komisionit Evropian për Maqedoninë vë në dukje se “përfshirja e OSHC-ve në hartimin e politikave dhe legjisllacionit mbetet e pamjaftueshme, edhe pse nga Sekretariati për Çështje Evropiane janë bërë disa përpjekje të mëtejshme.”⁴⁰

39 OSHC u mblodhën në Konventën Kombëtare për BE për Kapitullin 23 përfaqëson deri tani grupin më të madh të punës të kësaj Konvente. Për më shumë hollësi vizitoni: <https://goo.gl/cZbHCS>

40 Komisioni Evropian, Dokument Pune, Progres Raport për Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, 2016, Gjetendet tek: <https://goo.gl/gMv08p>, fq. 9

III. Nxitja e kërkesës për politikëbërje të qëndrueshme përtej kushtëzimit nga BE

Mbrojtja e nevojës për një Qendër Ekselence për Politikëbërjen

Gjendja e përshkruar nxjerr në pah nevojën për angazhim më të madh të OSHC-ve në të gjithë rajonin për t'i kërkuar llogari qeverive të tyre dhe për të advokuar për më shumë politikëbërje të bazuar në evidencë. Kjo gjendje evidenton edhe nevojën urgjente për të fuqizuar sektorin e shoqërisë civile në mënyrë që ky i fundit të marrë një rol më thelbësor në reformat dhe proceset e politikëbërjes. Mekanizmat ekzistues të formulimit, monitorimit dhe raportimit të politikave janë të pamjaftueshme për të siguruar reforma të qëndrueshme të politikëbërjes. Për këtë arsye, gjashtë organizatave hulumtuese nga Ballkani Perëndimor⁴¹ vendosën të krijojnë një Qendër Rajonale të Ekspertizës për Sistemet e Politikëbërjes në Ballkanin Perëndimor (QESP BP).

Kjo qendër u ngrit duke u bazuar në bashkëpunimin e ngushtë mes organizatave të përfshira në të. Ky bashkëpunim ka evoluar në radhë të parë brenda rrjetit rajonal të organizatave hulumtuese të

41 Këto organizata janë: Qendra e Politikave Evropiane (European Policy Centre - CEP) nga Beogradi, Instituti Alternativa (Institute Alternative - IA) nga Podgorica, Instituti i Politikave Evropiane (European Policy Institute - EPI) nga Shkupi, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) nga Tirana, Grupi për Studime Ligjore dhe Politike (GLPS) nga Prishtina dhe Nisma e Politikave të Jashtme (Foreign Policy Initiative - FPI) nga Sarajeva.

Rrjetit Mendoni për Evropën (TEN),⁴² në përgjigje të bashkëpunimit të dobët rajonal në hulumtimet lidhur me politikën e BE-së, veçanërisht në fushat e përfshirjes së shoqërisë civile në hartimin e politikave dhe në vendimmarrje, dimensionit rajonal të procesit të anëtarësimit në BE, reformës së administratës publike dhe kapaciteteve administrative për integrimin në BE, qeverisjes së mirë dhe përgjegjshmërisë së qeverisë. Përveç kësaj, duke filluar nga fundi i vitit 2015, gjashtë organizata kanë zbatuar një projekt trevjeçar që synon forcimin e pjesëmarrjes së shoqërisë civile dhe mediave në kuadër të reformës së administratës publike (i njohur si projekti WeBER),⁴³ ku komponentë të rëndësishme i kushtohen politikëbërjes dhe qeverisjes së mirë në rajon. Për këtë arsye, QESP BP do të shërbejë si një tjetër nxitje për nismat e tjera të përbashkëta, dhe anasjelltas, duke siguruar një grup ekspertize dhe mbështetje për përpjekjet më të strukturuar dhe projekteve të vazhdueshme të organizatave të përfshira.

Misioni i Qendrës është të promovojë përdorimin e hulumtimeve e kërkimeve si bazë për politikëbërje dhe vendimmarrje në Ballkanin Perëndimor, duke siguruar kontribut të bazuar në evidencë dhe me cilësi të lartë për të çuar më tej proceset ekzistuese të politikave. Në përmbushje të misionit të saj, Qendra do të ndërtojë partneritete të qëndrueshme mes anëtarëve të saj dhe aktorëve kryesorë në nivel kombëtar, rajonal dhe të BE-së. Duke u bazuar në hulumtimet e saj krahasuese në nivel rajonale, Qendra do të mbështesë dialogun rajonal të politikës duke u fokusuar në praktikën më të mira të rasteve dhe në nxitjen e konkurrencës së shëndetshme mes këtyre gjashtë vendeve. Objektivi afatgjatë i Qendrës është të kthehet në një qendër të pavarur ekselence me një rrjet të gjerë ekspertësh rajonalë dhe ndërkombëtarë me strukturat e veta operative.


Deri në vitin 2025, QESP BP parashikon të bëhet qendra lider e pavarur rajonale që realizon kërkime moderne në politikëbërje. Anëtarët e Qendrës synojnë të përbëjnë një rrjet të larmishëm studiuesish të njohur për ekspertizën e tyre dhe të mbrojnë me sukses idetë dhe gjetjet e tyre para aktorëve kryesorë kombëtarë, rajonalë dhe të BE-së. Qendra do të përpiqet të lë gjurmë si faktor korrigjues i praktikave ekzistuese të politikëbërjes në rajon.

42 Rrjeti Mendo për Evropën, për më shumë informacion vizitoni: <http://ten.europeanpolicy.org/>

43 Projekti i Ballkanit Perëndimor për forcimin e pjesëmarrjes së shoqërisë civile dhe mediave në kuadër të reformës së administratës publike - WeBER, <http://www.par-monitor.org/>

Kështu, Qendra synon të trajtojë si ofertën ashtu edhe kërkesën për politikëbërje efektive dhe të bazuar në evidencë. Ajo do të angazhohet në këto tre drejtime njëkohësisht:

- Kërkime të përbashkëta për tema në lidhje me hartimin e politikave, të tilla si: pjesëmarrja e OSHC-ve në hartimin e politikave, monitorimin e politikave, si dhe proceset e tjera që lidhen me procesin e përgjithshëm të reformës së administratës publike në vendet e rajonit; qeverisja e mirë (d.m.th., partneriteti qeverisjes së hapur dhe nismat e të dhënave të hapura); dhe monitorimin e procesit të anëtarësimit në BE. Këto tema janë të përbashkëta për të gjithë anëtarët e Qendrës QESP BP, por niveli i ekspertizës së tyre ndryshon nga një çështje në tjetrën. Nëpërmjet aktiviteteve kërkimore të kryera bashkërisht, anëtarët e Qendrës do të përforcojnë në mënyrë reciproke ekspertizën e njëri-tjetrit duke rritur kështu kapacitetet e përgjithshme të Qendrës për të vepruar si një kontrollor efikas i reformave dhe proceseve të politikëbërjes.
- Nisma të përbashkëta advokacie drejtuar qeverive qendrore, vendimmarrësve në BE si dhe nisma të tjera që synojnë rritjen e bashkëpunimit rajonal, bazuar në kërkime të kryera më parë.



- Aktivitete për ngritjen e kapaciteteve. Qendra do të fokusohet fillimisht në ngritjen e kapaciteteve të brendshme nëpërmjet kërkimeve të përbashkëta, konsultimeve, vizitave studimore mes anëtarëve të saj si dhe trajnime e kërkime të përbashkëta të realizuara nga ekspertë dhe institucione të njohura të jashtme. Në planin afatmesëm, duke ofruar trajnime të person-

alizuara për ngritje kapacitetesh, Qendra do të fuqizojë OSHC të tjera me qëllim që ato të bëhen aktorë më konstruktivë në procesin e hartimit dhe monitorimit të politikave. Në planin afatgjatë, Qendra do të kërkojë të kthehet në një institucion i njohur trajnimi për politikëbërje të bazuar në evidencë si dhe të ofrojë shërbime për institucionet në nivel qendror e ato në nivel vendor, si bashkitë e qarqet.

Ja shembulli i përsosur i arsytimit për bashkëpunimin rajonal

Për arsye të ndryshme misioni i Qendrës QESP BP nuk mund të përmbushet plotësisht pa trajtuar nismat e reformës së politikëbërjes nga pikëpamja rajonale. Nga perspektiva e ngritjes së kapaciteteve të brendshme të organizatave anëtare të Qendrës, kjo e fundit synon të përfitojë sa më shumë nga mësimet dhe përvoja e anëtarëve si dhe nga shkëmbimi i njohurive, duke pasur parasysh se problemet dhe sfidat me të cilat përballen këto organizata janë të ngjashme dhe të krahasueshme mes të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, anëtare të kësaj qendre. Këto praktika të të mësuarit mund të kenë efekt gjithëpërfshirës, pra ato mund të nxisin shkëmbimin e qëndrueshëm rajonal të praktikave të mira mes aktorëve të tjerë të sektorit të shoqërisë civile, duke kontribuar kështu në fuqizimin e OSHC-ve në rajon. Nga perspektiva e kapaciteteve e mbrojtjes së interesave (advokim), presioni nga organizatat partnere rajonale i ngritur në bazë të kërkimeve të bazuara në evidencë, së bashku me rritjen progresive të ekspertizës së sektorit të shoqërisë civile për të vepruar në mënyrë konstruktive në

kuadër të reformave të politikave dhe proceseve do të rrisë potencialin e Qendrës në këtë drejtim dhe aftësinë e saj për të formësuar debatet lidhur me këto reforma dhe procese të rëndësishme.

Fakti që të gjithë anëtarët e Qendrës vijnë nga shtetet që synojnë të anëtarësohen në BE ofron mundësi të tjera për presion ndaj qeverive të tyre për të dhënë rezultate konkrete me reformat e tyre të politikëbërjes. Presioni i krijuar përmes Qendrës do të ushtrohet paralelisht me vlerësimet ekzistuese të SIGMA/OECD-së. Gjithsesi, ndryshe nga këto vlerësime që kryhen në kuadër të negociatave për anëtarësim në BE, angazhimi i Qendrës do të mbetet i pranishëm në një plan afatgjatë dhe pa marrë parasysh rezultatin e anëtarësimit të vendeve të BE-së. Në fakt, cilësia e reformave të parashikuara ka gjasa të bëhet më e lartë në rast të angazhimit të një numri më të madh monitoruesish të shoqërisë civile në terren.

Ndjekja e një qasje rajonale përmes Qendrës QESP BP, pavarësisht avantazheve tashmë të evidentuara, ka një tjetër vlerë të shtuar më të madhe dhe të nënkuptuar, vlerë që ka të bëjë me përmirësimin e imazhit të rajonit të Ballkanit Perëndimor në Evropë dhe më gjerë. Duke pasur parasysh kushtet e karakterizuar nga kriza të shumta në BE, nga mungesa serioze e solidaritetit dhe nga rreziku i fragmentimit të kontinentit, Qendra do të përbëjë një shembull pozitiv të anës tjetër të monedhës si dhe efektin e “pushtetit të butë” në mbështetje të projektit evropian për vendet që synojnë të anëtarësohen në BE. Në këtë mënyrë, Qendra do të synojë të bëhet në një aktor i shquar përtej rajonit, shembulli i së cilës do të mund t’i japë një shtysë debateve të vazhdueshme për të ardhmen e kontinentit.

Rreth Projektit

Qëllimi i projektit Qendra e Ekselencës në Sistemet e Politikëbërjes në Ballkanin Perëndimor (CEPS Web) ishte krijimi i një Qendre të Ekselencës brenda kornizës institucionale të ofruar nga Think for Europe Network (TEN). Anëtarët e saj janë gjashtë think tanks organizata nga Ballkani:

- Perëndimor duke përfshi European Policy Centre - Beograd
- Institute Alternativa - Podgoricë
- European Policy Institute - Shkup
- Foreign Policy Initiative - Sarajevë
- Institute for Democracy and Mediation - Tirana
- Group for Legal and Political Studies - Prishtinë.

Projekti financohet me kornizën e Regional Research Promotion Programme (RRPP). RRPP promovonë hulumtime në shkencat sociale në Ballkanin Perëndimorë (Shqipëria, Bosnia dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia). Hulumtimet në shkencat sociale ndihmojnë në sqarimin e reformave specifike të shteteve në rajon dhe në identifikimin e implikimeve afatgjata të zgjedhjeve. Hulumtuesit pranojnë mbështetje përmes granteve hulumtuese, trajnimeve metodologjike dhe tematike, si dhe përmes mundësive rajonale dhe internacionale të rrjetëzimit dhe mentorimit. RRPP është kordinuar dhe operon nga Interfaculty Institute for Central and Eastern Europe (IICEE) në University of Fribourg (Zvicër). Programi është i financuar nga Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC), Federal Department of Foreign Affairs. Pikëpamjet e shprehura në këtë analizë politikash janë të autorve dhe jo domosdoshmërisht reprezentojnë opinionet e SDC dhe të University of Fribourg.

Beograd, Nëntor 2016



 ten.europeanpolicy.org

 [/thinkforeuropenetwork](https://www.facebook.com/thinkforeuropenetwork)

 [@ThinkforEurope](https://twitter.com/ThinkforEurope)